



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 18.11.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Ibrahim Selmanaj, Zulfi Merxha, Elhëme Hetemi, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Zef Morina dhe Ali Lajçi, Lulzim Zeneli.
Munguan : Dragisha Miriç, Zef Morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Blerim Vela-OSCE

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës, ndërsa **Selvie Halimi** propozoi riformulimin e pikës 2 : Shqyrtimi i nenit 59 dhe 60 të projektligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe informimi nga zyrtari i OSCE me të dhënat për detyrat e Agjencioneve në shtetet e rajonit, çka u miratua nga komisioni.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe informata nga zyrtari i OSCE

Kryesuesi (fillimin e mbledhjes e kryesoi nënkryetari Zylfi Merxha, më pastaj vazhdoi kryesimin kryetari Lulzim Zeneli) në fillim përshëndeti anëtarin e ri të komisionit Dragisha Miriç i cili zëvendëson Kosara Nikoliç, i cili falënderoi për mikpritje dhe njoftoi komisionin se i njëjti është ing. për agronomi.

Blerim Vela prezantoi komisionit analizën me shkrim të agjencive për mbrojtje të mjedisit në vendet e rajonit dhe Evropës duke paraqitur strukturën dhe përgjegjësitë në secilin shtet veç e veç. Në bazë të analizës së tillë komisioni riformuloi dy nenet e mbetura për mbledhjen e sotme si vijon :

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës

Neni 59.

- 1....Me qëllim të monitorimit të cilësisë dhe vetive të mjedisit , Ministria themelon Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (këtu e tutje : AMMK).
- 2....Struktura organizative dhe përgjegjësitë tjera të AMMK përcaktohen me akt nënligjor.

Detyrat e AMMK

Neni 60

1. Detyrat e AMMK janë :
 - a) të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
 - b) të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë **të dhënat** për mjedisin;
 - c) ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (**të dhënat** socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
 - d) të zhvillojë procedurat për përpunimin e **të dhënave** të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
 - e) të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit.
 - f) të avancojë dhe krahasojë cilësinë e të dhënave për mjedisin;
 - g) të hartojë raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve, si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojlojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
 - h) të hartojë raporte për çështjet e caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndeti dhe ngajshëm;
 - i) kryen punë këshillëdhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;**
 - j) të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
 - k) të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit - AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim – RrEIV;**
 - l) të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit ;**
 - m) të sigurojë qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve të AEM.**
 - n) shfrytëzimi dhe këmbimi ndërshtetëror i të dhënave për mjedis do të rregullohet me ligj të veçantë.**
2. AMMK kryen edhe punë të tjera të përcaktuara në aktin për themelimin që shërbejnë për realizimin e veprimtarisë së AMMK të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Komisioni konstatoi se me hartimin e dy neneve të sotme përfundoi shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili do të shërbej si bazë për punën e mëtejme me dy projektligjet tjera. **Selvie Halimi** njoftoi komisionin për punën e grupit punues i cili në javën e ardhshme do të përfundoi dy projektligjet (VNM dhe VSM) të caktuara nga komisioni për shqyrtim nga grupi punues, ndërsa **Blerim Vela** propozoi që në punën e GP të ftohet ai dhe Zeqir Veselaj sa i përket projektligjit të VSM.

Të ndryshme

Komisioni për të mërkurën më 19.11.2008 në orën 10,00 (njsja) vendosi të vizitoi komunën e Pejës me anëtarët : **Ali Lajçi, Berat Luzha dhe Heset Cakolli** , të cilët do të përfaqësojnë komisionin në komunën e Pejës (nëse ka mundësi do të bashkëngjiten ende anëtarë të komisionit këtyre tre anëtarëve, në këtë vizitë).

Mbledhja përfundoi në orën 14,30

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli